

ZICO SHA

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022

(Vlerat janë në Lek)

V. Shënime Mbi Pasqyrat Financiare

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "ZICO" SHA është krijuar juridiksht me vendimin e Gjykatës nr. 34285, datë 04.11.2005 si dhe është regjistruar në QKB në datën 04.11.2005.

Selia e Shoqërisë ndodhet në Vaqarr, Tirane.

NIPT-i i Shoqërisë është K61812006M. Administratori i Shoqërisë është z.Petrit Demishaj.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është importi, eksporti dhe tregtimi i produkteve ushqimore, kryesisht banane, mish i ngrirë dhe produkte të tjera (ushqimore). Shoqëria është një shoqëri aksionere me një kapital prej 560,000,000 Lekë i ndarë në 2,000 aksione me vlerë nominale prej 280,000 Lekë.

Këshilli Mbikqyrës përbëhet:

- | | |
|----------------------|---------|
| 1. Anastas Kriqi | Kryetar |
| 2. Desantila Murataj | Anëtar |
| 3. Mikel Selami | Anëtar |

Numri mesatar i të punëuarve nga 01.01.2022 deri më 31.12.2022 është 150 punonjës.

Referuar Nenit 2 pika 23 germa ç të Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar" shoqëria ZICO Sha kategorizohet në: **Njësi ekonomike me interes publik.**

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

2.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Ndryshimet e mëposhtme në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri i lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK), janë në fuqi për periudhën raportuese:

- **Ndryshime në SNK 7 "Pasqyra e Lëvizjes së Parasë"**- Iniciativa e informacioneve shpjeguese (efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017),
- **Ndryshime në SNK 12 "Tatimi mbi të Ardhurat"** – Njohja e aktiveve tatimore të shtyra për humbjet e parealizuar (efektive për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017),
- **Ndryshime në SNRF 12 si pasojë e "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2014-2016)"** rezultuar nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 1, SNRF 2, dhe SNK 28) kryesisht me një pikëpamje për të eliminuar mospërputhjet dhe për të qartësuar formulimin (ndryshimet mbi SNRF 12 do të jenë të aplikueshme për periudhat vjetore duke filluar në ose pas datës 1 Janar 2017).

Miratimi i këtyre ndryshimeve në standardet ekzistuese nuk ka çuar në ndonjë ndryshim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

2.2. Standardet dhe interpretimet e emetuara që futen në fuqi më 01 Janar 2018

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e reja të mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri ishin publikuar, por ende jo efektive:



ZICO SHA

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022

(Vlerat janë në Lek)

Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

3.5.2.Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

4. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e pasqyrave financiare. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 është detajuar si më poshtë:

Kurset e Këmbimit	31.12.2022	31.12.2021
Euro/Leke	114.23	120.76
USD/Leke	107.05	106.54
GBP/Leke	128.92	143.95
CHF/Leke	116.13	116.82

4.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.



ZICO SHA

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022

(Vlerat janë në Lek)

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale të aksioneve

4.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur koston e tyre historike dhe përfshirjen e të gjitha shpenzimeve të kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike.

4.4. Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin(+/-) dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundur që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i Aktiveve Afatgjata llogaritet sipas normave të amortizimit Fiskal, Amortizimi i vlerësuar për vitin 2021 dhe 2022 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Amortizimi
Ndërtesa	5%, Mbi Vlerën e Mbetur
Kompjutere, Software etj	25%, Mbi Vlerën e Mbetur
Makineri dhe pajisje	20%, Mbi Vlerën e Mbetur
Aktivitet e Pa Trupezuara	15%, Linear
Te Tjera	20%, Mbi Vlerën e Mbetur

Keto metoda amortizimi zbatohen për asetet e ZICO SHA.

Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.



ZICO SHA

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022

(Vlerat janë në Lek)

5. Aktivet afatgjata materiale

Toka	Ndertesa	Aktive Jo Materiale	Ndertime & Instalime	Makinieri dhe pajisje	Mjete Transporti	Pajisje informatike	Ndertime Ne Proces	Aktive Biologjike	Total
Vlera bruto e AAM me 31.12.2021	467,513,990	112,084,506	6,921,180	61,297,177	101,383,695	7,563,574	303,032,092	320,500	1,060,116,713
Shtesa gjate 2022	228,547,950	5,386,492	-	4,280,067	3,619,212	1,396,208	74,414,244	-	317,644,173
Pakesime	-	-	-	-	-	(494,435)	(5,965,930)	-	(6,460,365)
Vlera bruto e AAM me 31.12.2022	696,061,940	117,470,998	6,921,180	65,577,244	105,002,907	8,465,347	371,480,406	320,500	1,371,300,521
Amortizimi i akumuluar 31.12.2021	-	4,827,647	5,188,041	19,640,157	46,422,449	3,970,682	-	-	80,048,976
Pakesime	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Amortizimi i vitit 2022	-	5,577,037	1,038,177	8,657,399	11,429,071	987,319	-	117,839	27,806,841
Amortizimi i akumuluar, 31 dhjetor 2022	-	10,404,684	6,226,218	28,297,555	57,851,520	4,519,348	-	117,839	107,417,163
Vlera neto e AAM 2022	696,061,940	107,066,314	694,962	37,279,689	47,151,387	3,945,999	371,480,406	202,661	1,263,883,358
Vlera neto e AAM 2021	467,513,990	107,256,859	1,733,139	41,657,020	54,961,246	3,592,891	303,032,092	320,500	980,067,737

Për te gjithë aktivet shoqëria ZICO SHA amortizimin e llogarit sipas normave fiskale.



ZICO SHA viti 2022*(Vlerat janë në Lek)***6. Inventarë**

Balancat e inventarit më 31 Dhjetor 2022 dhe 2021 paraqitet si më poshte:

	<u>31.12.2022</u>	<u>31.12.2021</u>
Mallra ne Magazine	247,309,109	316,513,549
Mallra ne Magazine Doganore	<u>107,075,038</u>	<u>106,262,338</u>
TOTALI	354,384,147	422,775,887

7. Llogari të arkëtueshme e të tjera arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme detajohen si më poshtë:

	<u>31.12.2022</u>	<u>31.12.2021</u>
Llogari te arketueshme tregtare	361,265,452	218,758,158

	<u>31.12.2022</u>	<u>31.12.2021</u>
Llogari te tjera te arketueshme		
TVSH Kreditore	53,551,053	150,714,363
Gjendje Debitore ne Dogane	730,987	547,016
Parapagime te dhena	0	520,375
Rivleresime tatimore (Kontrolli M. Meckaj)	1,792,606	1,792,606
Rivleresime Tatimore A Haklaj+ Mosleshim kuponi tatimor (PROCES GJYQESOR)	17,726,267	17,726,266
Dhene Borxh Bana King-ut, Claimi I AJC	-	32,983,711
Interesat nga Kredia e dhene Bana King-ut	-	6,596,531
Dhene Borxh Proinfinit sipas kontrates dt 22.03.2021	-	3,000,000
Dhene borxh per punonjesit	3,883,820	4,105,840
DHENE BORXH BEKTASH MUCA KONTR. NR 12578REP, NR4770 KOL, DT.19/10/2020	-	19,092,156
DHENE BORXH ARJAN MUCA KONTR. NR. 12574 REP, NR.4766 KOL, DT.19/10/2020	-	19,092,156
DHENE BORXH HASAN MEHMET MUCA KONTR. NR. 12581 REP, NR. 4772 KOL, DT.19/10/2020	-	19,092,156
DHENE BORXH HASAN ABDYL MUCA KONTR. NR 12576 REP, NR. 4768 KOL, DT.19/10/2020	-	19,092,156
DHENE BORXH JONID ZAHAI, KONTR. NR. 4541 REP, 2478 KOL, DT 10/11/2020	4,569,200	4,830,400
DHENE BORXH GERTI BRAHJA, KONTR. NR. 28 REP, 21 KOL, DT 06/01/2022	72,239,052	-
DHENE BORXH JONID ZAHAI, KONTR. NR. 4162 REP, 2747 KOL, DT 19/07/2022	6,000,000	-
Garanci bankare per pullat fiskale	527,175	527,175
Pulla fiskale	2,010	-
	161,022,170	299,712,907

8. Shpenzime për të shpërndarë

	<u>31.12.2022</u>	<u>31.12.2021</u>
Shpenzime te shtyra	15,983,882	-



ZICO SHA viti 2022
(Vlerat janë në Lek)

9. Mjetet monetare

Gjendja e mjeteve monetare më 31 Dhjetor 2022 dhe 2021 paraqitet si më poshtë:

	<u>31.12.2022</u>	<u>31.12.2021</u>
Mjete Monetare ne Banke	43,496,730	48,596,838
Mjete Monetare ne Arke	4,055,228	9,378,778
	47,551,958	57,975,616

10. Kapitali

Kapitali i Shoqërisë është në vlerën 560,000,000 Lekë i ndarë në 2,000 aksione me vlerë nominale 280,000 Lekë për aksion. Aksionet zotërohen 100% nga z.Trifon Murataj.

	Nr Pjeseve	Vi. Nominale	Struktura	Kapitali Aksionar (ne Leke)
Trifon MURATAJ	2,000	280,000	100%	560,000,000

Rezervat ligjore janë në vlerën 52,858,054 Lekë.

Rezervat e tjera të Shoqërisë janë në vlerën 0 Lekë.

Fitim/humbja e vitit ushtrimor është në vlerën 307,533,005 Lekë.

11. Hua afatgjata

Huatë afatgjata më 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2021 detajohen si më poshtë :

	<u>31.12.2022</u>	<u>31.12.2021</u>
Kredi	104,727,545	95,039,864
Leasing	4,074,059	7,601,393
	108,801,603	102,641,257

12. Grante, të ardhura të shtyra dhe të tjera detyrime

Balanca e granteve të ardhurave të shtyra dhe të tjera detyrimeve më 31 Dhjetor 2022 dhe 2021 paraqitet si më poshtë:

	<u>31.12.2022</u>	<u>31.12.2021</u>
Grante, te ardhura te shtyra dhe te tjera detyrime	-	-

13. Hua afatshkurtra

Huatë afatshkurtra të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2022 dhe 2021 detajohen si më poshtë:

	<u>31.12.2022</u>	<u>31.12.2021</u>
Hua Afatshkurter Overdrafte	235,445,580	257,253,616
	235,445,580	257,253,616



14. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 detajohen si më poshtë :

	<u>31.12.2022</u>	<u>31.12.2021</u>
Llogari te pagueshme tregtare	878,389,813	930,313,451
	878,389,813	930,313,451

15. Detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore të kompanisë më 31 Dhjetor 2022 dhe 2021 detajohen si më poshtë :

	<u>31.12.2022</u>	<u>31.12.2021</u>
Detyrime per tatimin aktual		
Sigurime shoqërore dhe shëndetsore	2,493,317	2,221,356
Tatim mbi fitimin	12,513,160	20,867,174
Tatimi në burim	36,138	42,293
Tatime dhe Rivleresime Tatimore 1 (nr 3648/11 dt 05.12.2018)	857,906	857,906
Detyrime nga rivleresime tatimore 2 (nr 5111/5 dt 25.01.2019 +mosleshim kuponi+nr 2999/8 dt 28.06.2021)	4,288,030	4,288,030
Detyrime nga rivleresime tatimore 3 (nr 7376/6 dt 19.01.2023)	676,085	-
	<u>20,864,636</u>	<u>28,276,759</u>

16. Detyrime të tjera

Detyrime të tjera më 31 Dhjetor 2022 dhe 2021 përbëhen si më poshtë:

<u>Llogari te tjera te pagueshme</u>	<u>31.12.2022</u>	<u>31.12.2021</u>
Parapagime te marra	0	2,808,000
Paga per tu paguar personelit	40,198,277	42,975,288
Detyrime te tjera	-	2,153,883
	<u>40,198,277</u>	<u>47,937,171</u>

17. Të ardhura nga shitja

Të ardhurat nga shitja për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022 dhe 2021 detajohen si më poshtë :

<u>Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit</u>	<u>31.12.2022</u>	<u>31.12.2021</u>
Te ardhura nga shitja e mallrave	5,027,239,677	4,966,502,291
Te ardhura nga qeraja	7,762,137	4,322,412
Shitje materiale te para dhe ndihmese	-	1,504,860
Shitje e produktit te gatshem	-	1,904,826
Te ardhura nga Autofaturimet	-	12,247,068
Te ardhura te tjera	300,672	121,260
Te ardhura nga shitja e AAM	54,167	12,885,393
Te ardhura nga transport per te Trete	735,988,003	7,155,087
	<u>5,771,344,656</u>	<u>5,006,643,197</u>



Rakordim i raportimit ne sistemin tatimor me shifren e afarizmit.

Shoqeria gjate vitit 2022 ka raportuar ne sistemin tatimor te ardhura nga shitja permes librave te shitjes dhe FDP shumen **5,768,536,656** leke.

Shifra e afarizmit deklaruar ne Pasqyrat Financiare per vitin ushtrimor mbyllur me 31.12.2022 e ndare sipas pasqyres se mesiperme eshte **5,771,344,656** lekë dhe perbehet nga:

- **5,768,536,656** leke janë të ardhura nga **Aktiviteti i Shfrytëzimit**, të realizuara gjatë vitit 2022
- **2,808,000** leke janë Parapagime të marra nga vitin 2021 dhe kaluar në shitje për vitin 2022

18. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera të Shoqërisë për 31 Dhjetor 2022 dhe 2021 detajohen si më poshtë :

	<u>31.12.2022</u>	<u>31.12.2021</u>
Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	-	-

19. Materiale të para dhe të konsumueshme

Shpenzimet për materialet e para dhe të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022 dhe 2021 janë si më poshtë :

	<u>31.12.2022</u>	<u>31.12.2021</u>
Kostoja e Mallrave dhe Sherbimeve te Shitura	(4,355,214,090)	(4,500,451,165)
	(4,355,214,090)	(4,500,451,165)

20. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022 dhe 2021 detajohen si më poshtë:

	<u>31.12.2022</u>	<u>31.12.2021</u>
Pagat Bruto	86,114,959	62,616,752
Kontributet e sig. shoqerore	14,153,155	10,365,074
Shpenzime te tjera per personelin	-	-
	100,268,114	72,981,826

21. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzimet e amortizimit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022 dhe 2021 detajohen si më poshtë:

	<u>31.12.2022</u>	<u>31.12.2021</u>
Shpenzime amortizimi dhe zhvleresimi	27,806,841	20,503,673
	27,806,841	20,503,673



22. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë :

	<u>31.12.2022</u>	<u>31.12.2021</u>
Materiale ndihmese	823,322	378,985
Karburant	71,192,591	83,239,660
Energji+Uje	24,802,338	25,106,174
Qera	14,620,967	14,879,680
Kancelari	4,201,942	3,477,754
Mirembajtje dhe Riparime	12,707,260	15,434,374
Siguracione	4,076,773	3,735,259
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	1,352,368	1,552,795
Taksa dhe tarifa vendore	1,805,691	1,940,969
Autofaturime per Trajtime te Pergjithshme	-	12,247,068
Komisione te ndermjetesve dhe Honorare	1,482,372	1,482,372
Publicitet, reklama	23,199,920	16,677,056
Transferime, Udhetime, Dieta	6,110,846	19,071,215
Pritje dhe Perfaqesime	612,554	549,705
Shpenzime per sherbimet bankare	3,249,184	7,748,804
Takse regjistrimi	-	-
Gjoha dhe demshperblime	16,838,563	31,250,629
Vlera kontabel e aktive afatgjata te shitura	-	-
Komisione per klientet	799,911	1,075,158
Transport per shitje MSC-BANA KING	738,137,246	-
Te tjera	10,904,456	17,879,897
	936,918,302	257,727,556

23. Shpenzime interesi dhe të ngjashme e të tjera financiare

Shpenzimet e interesit dhe të ngjashme për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022 detajohen si më poshtë:

	<u>31.12.2022</u>
Te Ardhura/ Shpenzime nga interesat	(14,317,981)
Fitim/Humbje nga Kursi Kembimit	25,485,956
Të ardhura të tjera financiare	2,469,763
	13,637,738

24. Rezultati Tatimore

Përlllogaritja e rezultatit tatimor 2022 paraqitet si më poshtë :

	<u>31.12.2022</u>
Fitimi (Humbja) para Tatimit	364,775,046
Shpenzime te panjohura(Gjoha e Interesa Tatimore)	16,838,563
Shpenzime te panjohura te tjera	-
Humbje e mbartur nga viti kaluar	-
Fitimi (Humbja) Tatimore	381,613,610
Tatimi mbi Fitimin (15%)	(57,242,041)
Fitimi(Humbja) Neto	307,533,005



25. Transaksionet me palët e lidhura

Palë të lidhura janë ato, kur njëra prej paleve kontrollohet nga pala tjetër ose ka influence të rëndësishme në vendimarrjen financiare ose të biznesit të palës tjetër.

Transaksione me palë të lidhura Shoqëria ZICO sha nuk ka.

26. Manaxhimi i riskut financiar

Detyrimet financiare kryesore të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e pagueshme dhe të tjera detyrime. Qëllimi kryesor i këtyre detyrimeve financiare është të financojnë operacionet e shoqërisë dhe të sigurojnë garanci për mbështetjen e operacioneve. Shoqëria ka hua, llogari të arkëtueshme, mjete monetare dhe depozita afatshkurtra që sigurohen drejtpërdrejt nga operacionet e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të tregut, riskut të kreditit dhe riskut të likuiditetit. Manaxhimi i lartë i Shoqërisë mbikqyr manaxhimin e këtyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh: risku i normës së interesit, risku i kursit të këmbimit, risku i çmimit të mallrave dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit. Instrumentat financiar të prekur nga risku i tregut përfshijnë huatë, kreditë dhe depozitat.

Risku i normave të interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdorura për të financuar ato aktive. Zgjatja kohore përgjatë të cilës norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse, përcakton se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit.

Aktivitet dhe detyrimet e shoqërisë mbartin risk të normave të interesit.

	31.12.2022	31.12.2021
Instrumenta me interes fiks		
Aktive Financiare	-	-
Detyrime Financiare	108,801,603	102,641,257
	<u>108,801,603</u>	<u>102,641,257</u>
Instrumenta me interes variabel		
Aktive Financiare	-	-
Detyrime Financiare	235,445,580	257,263,616
	<u>235,445,580</u>	<u>257,263,616</u>

Risku i kreditit

Risku i kreditit është risku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operacionale të saj (pikë së pari prej llogarive të arkëtueshme) dhe prej aktiviteteve të saj financuese, që përfshijnë depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjerë financiarë. Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.



Përshkrimi	31 Dhjetor 2022			Total
	Deri në 6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	
Llogari tregtare të arketueshme dhe të tjera	522,287,622			522,287,622
Shpenzime per tu shperndare	-			-
Mjete monetare ne arke dhe ne banke	47,551,958	-	-	47,551,958
	569,839,580	-	-	569,839,580

Përshkrimi	31 Dhjetor 2021			Total
	Deri në 6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	
Llogari tregtare të arketueshme dhe të tjera	518,471,066			518,471,066
Shpenzime per tu shperndare	-			-
Mjete monetare ne arke dhe ne banke	57,975,616	-	-	57,975,616
	576,446,682	-	-	576,446,682

Risku i Likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do ti duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalon kërkesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkurruese. Shoqëria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.

31 Dhjetor 2022	Nga 1 deri 12 muaj	Nga 1 deri 5 vjet	Me shume se 5 vjet	Total
Llogari te arketueshme e te tjera	522,287,622			522,287,622
Shpenzime per tu shperndare	-			-
Mjete monetare ne arke dhe ne banke	47,551,958	-	-	47,551,958
Shuma	569,839,580	-	-	569,839,580
Detyrimet e pagueshme te tjera	(939,452,726)			(939,452,726)
Hua afatgjata (Leasing)		(4,074,059)		(4,074,059)
Hua afatgjata (Kredi)		(104,727,545)		(104,727,545)
Hua afatshkurtra	(235,445,580)			(235,445,580)
Shuma	(1,174,898,306)	(108,801,603)	-	(1,283,699,909)
Rreziku i likuiditetit me 31 Dhjetor 2022	(605,058,726)	(108,801,603)	-	(713,860,329)

31 Dhjetor 2021	Nga 1 deri 12 muaj	Nga 1 deri 5 vjet	Me shume se 5 vjet	Total
Llogari te arketueshme e te tjera	518,471,066			518,471,066
Shpenzime per tu shperndare	-			-
Mjete monetare ne arke dhe ne banke	57,975,616	-	-	57,975,616
Shuma	576,446,682	-	-	576,446,682
Detyrime te pagueshme e te tjera	(1,006,527,380)			(1,006,527,380)
Hua afatgjata (Leasing)		(7,601,393)		(7,601,393)
Hua afatgjata (Kredi)		(95,039,864.00)		(95,039,864)
Hua afatshkurter	(257,263,616)			(257,263,616)
Shuma	(1,263,790,997)	(102,641,257)	-	(1,366,432,254)
Rreziku i likuiditetit me 31 Dhjetor 2021	(687,344,315)	(102,641,257)	-	(789,985,572)

27. Vlera e drejtë e instrumentave financiare

Instrumentat financiare përfshijnë aktivet dhe detyrimet financiare. Aktivet financiare përbëhen nga gjendja e llogarive në bankë dhe të arkëtueshmet. Detyrimet financiare përbëhen nga të pagueshmet. Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare përfshihet në shumën në të cilën instrumenti mund të shkëmbëhet në një transaksion mes palëve të gatshme, dhe jo të detyrueshme të në një proces likuidimi



ZICO SHA viti 2022
(Vlerat janë në Lek)

ose shitje. Vlerat e drejta të të gjitha aktiveve financiare të shoqërisë përafrojnë vlerat e tyre kontabël kryesisht për shkak të maturimit afatshkurtër të këtyre instrumentave.

28. Angazhime dhe detyrime të kushtezuara

Detyrimet tatimore

Shoqëria është audituar nga organet tatimore për TVSH, për Sigurimet Shoqërore dhe të tjera vetëm për periudhën Janar-Korrik 2022. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

29. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Pas datës 31.12.2022 shoqëria nuk ka veprime që mund të ndikojnë në rezultatin e vitit financiar.

Petrit DEMISHAJ
Administrator i ZICO SHA

ANASTAS KRIJAN



Desantila MURATAJ
Hartuese e Pasqyrave Financiare

Desantila Murataj

